



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 661/3 Prot.

Tiranë, më 29.04.2021

VENDIM  
Nr. 77, datë 28.04.2021

**PËR NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 59 DATË 15.12.2020 "PËR MIRATIMIN  
E DOKUMENTACIONIT  
MBI RIORGANIZIMIN E CIKLIT TË TRETË TË STUDIMEVE  
"DOKTORATË" NË "AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI"  
NË FAKULTETIN E VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT"**

Në zbatim të neneve 38 "dh", 69/3, 79 të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë", në pikën 14/a, b, 15/c të VKM nr. 329, datë 12.04.2017 "Për trajtimin e veçantë të personelit akademik", në Udhëzimin nr. 7 datë 31.03.2021 të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për një ndryshim në Udhëzimin nr.1 dt. 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të nenit 20 "F" të Statutit të UST-së, të nenit 7, pika 16 të Rregullores së UST-së, Senati në mbledhjen e datës 29.04.2021

**VENDOSI:**

1. Të miratojë dokumentacionin mbi riorganizimin e ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti" në Departamentin e Lëvizjes dhe Shëndetit, pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit:
  - Rregulloren për organizimin dhe kryerjen e programit të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti".
  - Koston Financiare
  - Vendimin e Senatit nr.76, datë 29.04.2021 "Për një ndryshim në vendimin nr.19 datë 10.02.2021 "për miratimin e kuotave të pranimit për vitin akademik 2021-2022 në UST"
  - Projekt kërkimor shkencor në "Departamentin Lëvizja dhe Shëndeti";
  - Shtojca 3 dhe përshkrimi i projektit;

2. Universiteti i Sporteve të Tiranës mbështet anëtarët e stafit akademik në 25% të kostos së studimeve të doktoraturës si pjesë e kontributit për kërkimin shkencor dhe përparimin akademik.
3. Të propozojë për miratim Bordit të Administrimit tarifën e studimit të ciklit të tretë Doktoratë në Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti sipas tabelës bashkangjitur.
4. Me miratimin e këtyre ndryshimeve, Vendimi nr. 59 datë 15.12.2020 shfuqizohet.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. Agron KASA**



Tabela e tarifave të shkollimit për ciklin e tretë të studimeve

Nr.	Fakulteti	Emërtimi i programit të studimit	Cikli i programit të studimit	Tarifa e shkollimit (për kandidatët nga stafi efektiv) në lekë	Tarifa e shkollimit për të tjerë (në lekë)
1	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti	Cikli i tretë	600000	800000
2	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	Shkenca Sportive	Cikli i tretë	600000	800000